REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**
**SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE**

Nr. 5382 prot. Vau Dejës, më 16.09. 2021

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim **Z. Mark Bisha**
**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS**

**I nderuar zoti Kryetar,**
Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin Nr.8 "Për rishikim VKB Nr.46 dt.26.07.2021 'Mbi dhënie ndihme financiare familjes së shtetasit **Paulin Pylla** që i është dëmtuar banesa si rezultat i reshjeve të **dt.14.05.2021-15.05.2021**.

**KRYETARI**
Mark **BABANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

**Konceptoi:Valjeta Nikaj** , Përgjegjëse e Sektorit të Emergjencave Civile

Datë: 16/09/2021
Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1
Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA VAU DEJËS**
**SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE**

**PROJEKT VENDIM**
Nr. 8 datë 16/09/2021

**Rishikim Vendimi Këshilli Bashkiak Nr.46 dt.26.07.2021 "Mbi dhënie ndihme financiere familjes së shtetasit Paulin Pylla që i është dëmtuar banesa si rezultat i reshjeve të dt.14.05.2021-15.05.2021**

**Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:**

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerezore", Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve"si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr 80 dt.24.12.2020 mbi "Miratimin e Buxhetit të Vitit 2021", i konfirmuar nga Prefektura me shkresen Nr.19/1 dt.18.01.2021

Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës pas rishikimit të VKB nr.46 dt.26.07.2021 "Për dhënie ndihme financiare familjes së shtetasit **Paulin Pylla** për të përballuar dëmet e shkaktuara nga shirat e datës 14.05.2021-15.05.2021 që është banore i që është banorë i Njësisë Administrative Vau-Dejës të Bashkisë Vau-Dejës, i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë proces verbalin e konstatimit të gjendjes dhe dokumentacionin e vlerësimit të dëmeve , në vlerën totale **490.680** lekë (katërqinde nëntëdhjetë mije e gjashtëqind e tetëdhjete) për shtetasin **Paulin Pylla** banorë i Njësisë Administrative Vau-Dejës të Bashkisë Vau-Dejës.

2. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare **z.Paulin Pylla** në masën 30% të vlerës totale të dëmit me shumën **147.204** (Njëqind e katërdhjetë e shtatëmije e dyqind e katër)lekë ku bashkëngjitur është edhe preventivi i dëmeve në orendi , mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake.

3. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.
4. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i planifikuar në programin "Emergjencat Civile "i cili është miratuar në Buxhetin e Bashkisë sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr 80 dt.24.12.2020 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2021.

**Konfirmoi bazen ligjore**
Kristine **SHTATRI**

**Konceptoi**
Valjeta **NIKAJ**

**KRYETARI**
Mark **BABANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU-DEJES**

*Vau-Dejës, me...../..../2021*

## Preventivi i dëmeve në orendi,mobilie dhe pajisje elektroshtepiake

| Nr. | Emertimi | Njesia | Sasia | Çmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Lavatriçe Ariston | cope | 1 | 57,000 | 57,000 |
| 2 | Frigorifer LG303L | cope | 1 | 52,260 | 52,260 |
| 3 | Sobe Gorenje | cope | 1 | 43,980 | 43,980 |
| 4 | Minibare Kine | cope | 1 | 38,000 | 38,000 |
| 5 | Aspirator Gorenjë | cope | 1 | 18,840 | 18,840 |
| 6 | Dhomë gjumi matrimoniale | cope | 1 | 155,000 | 155,000 |
| 7 | Dyshek dopio | cope | 1 | 13,100 | 13,100 |
| 8 | Dhomë gjumi fëmijesh | cope | 1 | 77,000 | 77,000 |
| 9 | Dyshek Tek | cope | 2 | 7,600 | 15,200 |
| 10 | Etazher | cope | 1 | 11,000 | 11,000 |
| 11 | Mbajtëse këpucësh | cope | 1 | 7,600 | 7,600 |
| 12 | Varëse rrobash | cope | 1 | 1,700 | 1,700 |
| | **SHUMA TOTALE** | | | | **490,680** |
| | | | | | |

**GRUPI I PUNES**

**Valjeta NIKAJ** | **Denada DODAJ** | **Emanuel MARDODA**

MIRATOHET

**KRYETARI I BASHKISE**

**Mark BABANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU I DEJËS

Nr. 4777/3 Prot
Dt. 30.08.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT SHKODER**

Nr. 559/3 prot.

Shkodër, më 24.08..2021

**LËNDA:Në përgjigje të shkresës Nr.4777/2prot dat.12.08.2021 lidhur me vendimin Nr.46 date.26.07.2021 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.**

**KESHIILIT BASHKIAK VAU-DEJES**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 "Për Prefektin", Urdhërit të Ministrit te Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së Brendshme "Për organzimin dhe funksionimin e Institucionit te Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", Kreu II, neni 4, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore" ndryshuar, neni 29, neni 54/dh, neni 55/3, neni 64/c, Ligjit Nr.45/2019 "Për mbrojtjen Civile", te VKM Nr.329 dat.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkakatuara nga veprimtaria njerëzore", Kreu III, VKB Nr.80 date.24.12.2020 "Mbi miratimin e buxhetit të vitit 2021", Urdhërit të Prefektit Nr.50 dat.19.08.2021 "Për delegim kopetence për firmë", ***shqyrtoi VKB nr.46 datë 26.07.2021 Vau-Dejës: "Për dhënie ndihme të menjëhershme financiare në shumën 147.204 lekë familjes të Z.Paulin Pylla, NJAD Vau - Dejës për të përballuar dëmet , si pasojë dëmeve të shkaktuara nga shirat e datës 14.05.2021 - 15.05.2021", si dhe shkresës se sekretarit të këshillit bashkiak Vau-Dejës Nr.4777/2prot dat.12.08.2021, në përgjigje të shkresës sonë Nr.559/1prot dat.9.08.2021",*** konstatohet si më poshtë.

Në pikën 1 të VKB Nr.46 dat.26.07.2021 jeni shprehur vetëm për dhënie ndihme të menjëhershme në shumën 147. 204 (njëqind e katërdhjete e shtatëmije e dyqind e kater)leke, per Z.Pylla, pasi nuk është miratuar në asnjë pikë të vkb, dokumentacioni për vlerësimin e dëmit, pas shqyrtimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve nga ana e këshillit bashkiak, kërkesë e germes " ë " të pikës 1, kap III të VKM Nr.329 dat.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkakatuara nga veprimtaria njerëzore".

Në zbatim të pikës 2, germa c, të kap.III të VKM Nr.329 dat.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkakatuara nga veprimtaria njerëzore", paraqesin domodoshmëri *preventivat e dëmeve nga ana ndërtimore,* si dokumentacion i nevojshem për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare.

Sa me sipër Prefekti kërkon rishqyrtimin e vendimit me elementet e mësipërm sipas akteve ligjore në fuqi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
**Felek KASEMI**